

## Vllaznia/ Tifozet enderrojne titullin, lojtaret rrogat

nga AlbaniaSoccer  
E diel, 29 Shtator 2013 22:01

---



Ne Shkoder tifozet pas tri fitoreve rradhazi kane nisur te enderrojne shume. Golat e kroatit Bushic, talenti i Krujes, shpejtesia e Hajdarit dhe eksperienca e Rajovic dhe Beqirit japin shprese. Me Vllaznine e ketij viti ne fushe po zbresin 7-8 futbolliste shkodrane e te gjithë tani jane te dashuruar me lojen qe ekipi ben. Por lojtaret shpresojne per nje zgjidhje nga bashkia dhe kane te tjera endrra. Prej muajsh nuk kane marre rrogen dhe situata per ta eshte emergjente. Drejtuesit dhe kryetari i Bashkise zoti Luka kane ndare premio pas cdo fitore por rrogat akoma.